



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr 1 Shkodër,

web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al)

e-mail: [keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al](mailto:keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al)

V E N D I M

Nr. 14, datë 1.3.2017

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,  
të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 1.3.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "e" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017",

V E N D O S I :

1. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **znj. Sofie Rrashkadolli**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (reshje dëbore dhe ngrica). Familja e saj përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
2. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Marjan Rrashkadolli**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore (reshje dëbore dhe ngrica). Familja e tij përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.

Burimi i financimit të jetë fondi i drejtorisë së emergjencave civile dhe MZSH-së, parashikuar në buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017 të miratuar me VKB nr 8, datë 30.1.2017, në matrikullën P13, F1 O2A1

3. Ngarkohet bashkia Shkodër të bëjë likujdimin e shumës 140,000 lekë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miraturar në datën 1.3.2017

Shpallur në datën 1.3.2017



**Sekretar i këshillit**

**Suel Hadri**

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**